

VENDIM
Nr.803, datë 6.10.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR RRRITJEN E PAGAVE TË
PUNONJËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 2 857 726 (dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, për rritjen e pagave të punonjësve të këtij institucioni.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Kryeministria, Ministra e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha